



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri
Mbledhja nr. 33
Prishtinë, më 2 Shtator 2009
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225
Mbledhja filloi në orën 11:00

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri

Morën pjesë: Rrustem Mustafa, Emrush Xhemajli, Gani Geci, Agim Veliu, Melihate Termkollu, Ibrahim Selmanaj dhe Zylfi Merxha.

Munguan: Zafir Berisha, Eqrem Kryeziu, Bojan Stojanovič, Shkumbin Demaliaj.

Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë: Nur Çeku, Antigona Ibraj, Fatbardha Boletini dhe Nuredin Ibishi

Mbledhjen e kryesoi: Rrustem Mustafa, kryetari i komisionit.

Rendi i ditës

1. Situata aktuale e sigurisë në vend

***Kryetari** konstatoi se janë plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

Kryetari i Komisionit – tha, sot kemi mbledhjen e parë të komisionit për sesionin vjeshtor dhe do të diskutojmë për disa ngjarje të cilat e cenojnë sigurinë në Kosovë. Duhet të përmendi disa ngjarje të cilat kanë ndodhur në veri të Mitrovicës, te Kroi i Vitakut , pastaj zhvillimi në rajonin e Gjilanit në kufi ku ka hyrje të xhandarmerisë serbe në fshatrat shqiptare dhe sidomos mundësia e nënshkrimit të një protokoll bashkëpunimi

në mes të EULEX-it dhe Serbisë. Mbajtja e zgjedhjeve lokale të Republikës së Serbisë në Kosovë, është shkelje flagrante e sovranitetit të Republikës së Kosovës. Kjo mbledhje ka për qëllim që të nxjerr propozime konkrete.

Gani Geci – Mendoj që më shqetësuese është mbajtja e zgjedhjeve lokale të Republikës së Serbisë në Republikën e Kosovës, se sa çështja e protokollit. Kushtetuta si akti më i lartë përcakton, se cilat çështje mund të debatohen në Kuvendin e Kosovës. Hierarkia komanduese e Policisë është shqetësuese, sepse policët në veri nuk i zbatojnë urdhrat e Policisë së Kosovës por i zbatojnë urdhrat e dikujt tjetër.

Melihate Termkollli – Është duke u cenuar në masë të madhe siguria në vend dhe askush nuk ndërmerr asgjë. Ne e kemi pranuar EULEX-in, mirëpo EULEX-i është neutral ndaj statusit të Kosovës. Ne duhet të kemi një bashkëpunim, mirëpo duke u respektuar kompetencat e institucioneve të Kosovës.

Emrush Xhemajli – Për mendimin tim, janë duke treguar shumë pa aftësi, ata që janë përgjegjës në Qeveri dhe në menaxhimin e situatave. Nuk ka ndonjë bashkëpunim të duhur të mekanizmave në Kosovë dhe atyre ndërkombëtarë. Ne kemi bërë vërejtje që këta mekanizma të ndërmarrin hapa në lidhje me liberalizimin e vizave, në këtë drejtim nuk është bërë asgjë. Kemi kërkuar të na informojnë për dinamikën e punëve, mirëpo krejt çka kemi marr është një raport i thatë.

Ibrahim Selmanaj – Pavarësisht qëndrimeve shumë të qarta të komisionit ndaj drejtorit të policisë, në rastin e vjedhjes së dhomës së provave për përmirësimin e gjendjes së keqe, nuk është bërë asgjë.

Zylfi Merxha - Unë mendoj se nga organi kompetent duhet të kërkojmë që të na raportoj në lidhje me ngjarjet që kanë ndodhur në Mitrovicë.

Gani Geci – Sa i përket çështjes së vendosjes së kamerave gjatë procesit të votimit janë dhënë deklarata të ndryshme të partive politike. Kjo krijon një problem në mes të partive politike dhe mund të cenon sigurinë në vend. Nëse për bindje politike një person largohet nga puna, atëherë edhe kjo shkakton pasiguri në vend.

Agim Veliu – Të gjitha këto çështje që u shtruan sot nga ju, e shqetësojnë opinionin dhe qytetarët në përgjithësi. Pajtohem me ato që thanë kolegët e mi për mekanizmat e sigurisë, që nuk janë në nivelin e duhur.

Kryetari i Komisionit – **tha**, duhet të kërkojmë raporte nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Institucionet tjera. Për protokollin e EULEX-it, unë mendoj që nëse EULEX-i ka marr obligim nga Unioni Evropian, që të nënshkruajë marrëveshje me shtetet në rajon, atëherë protokollin duhet të nënshkruhet me MPB-në. A pajtoheni që të kërkojmë raporte nga Qeveria, Ministria e Punëve të Brendshme por edhe nga EULEX-i.

Anëtarët e komisionit u pajtuan me propozimin që të kërkohet raport.

Pasi që nuk kishte pika tjera për të diskutuar, kryetari i komisionit e mbylli këtë takim.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

Përgatiti:
Njësia Mbështetëse e Komisionit

Kryetar i Komisionit
Rrustem Mustafa